REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE Tirane
Nr. 8635 Rep.
Nr. 2466 Kol.

LIKUIDUAR TAKS E PULLES

# KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot, me date 10.09.2010, ne Tirane, perpara meje noterit Juljian Zhelegu Noter i Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten palet e meposhtme:

- **Z. Hysni Ymeri**, shtetas kosovar, lindur me 06.10.1976, ne Prizren, Kosove, mbajtes i pasaportes me nr. K00175095, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e zoteruesit te 75% te kapitalit te shoqerise **HYMERI KLEEMANN** sh.p.k. (me poshte referuar si "**Shitesi**"),

- **Z.Gentian Zguri**, shtetas shqipetar, lindur ne Tirane, me 30.04.1976, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr. 00514844 madhor me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e zoteruesit te 10% te kapitalit te shoqerise **HYMERI KLEEMANN** sh.p.k. (me poshte referuar si "**Bleresi**"),

Palet e siperpermendura (secila quajtur "**Pale**", ose bashkarisht "**Palet**") kane rene dakord te nenshkruajne kete kontrate shitblerje kuotash ("**Kontrate Shitblerje Kuotash**" ose "**Kontrata**") me qellim transferimin e pronesise mbi kuotat sic parashikohet me poshte ne kete Kontrate:

## NENI 1
## BLERJA E KUOTAVE NE SHITJE

1.1 Shoqeria **HYMERI KLEEMANN** sh.p.k. eshte nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles bazohet ne Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", e regjistruar rregullisht prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, me NUIS nr. K92309026B, me date 09.11.2009 ("**Shoqeria**").
1.2 Shitesi zoteron ne Shoqeri 75% (shtatedhjete e pese per qind) te kuotave te saj.

1.3 Nga 750 (shtateqind e pesedhjete) kuota qe Shitesi zoteron ne kapitalin e Shoqerise dhe qe perfaqesojne 75 % te kapitalit te Shoqerise, nepermjet kesaj Kontrate ai kalon ne pronesi te Bleresit 200 kuota qe perfaqesojne 20 % te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise.
Pas ketij transferimi kuotat e zoteruara nga secili prej ortakeve dhe perqindja e pjesemarrjes se secilit ne kapitalin e Shoqerise do te jene si me poshte:

- Ortaku **Hysni Ymeri** do te zoteroje **550** (peseqind e pesedhjete) kuota ne kapitalin e Shoqerise te cilat perfaqesojne **55%** te pjesemarrjes ne kapital;

- Ortaku **Gentjan Zguri** do te zoteroje **300** (treqind) kuota ne kapitalin e shoqerise te cilat perfaqesojne **30** % te kapitalit te saj;

- Ortaku **Afrim Kuci** do te zoteroje **100** (njeqind) kuota ne kapitalin e Shoqerise te cilat perfaqesojne **10** % te kapitalit te saj;

- Ortaku **Burim Krasniqit** do te zoteroje **50** (pesedhjete) kuota ne kapitalin e Shoqerise te cilat perfaqesojne **5** % te kapitalit te saj.

1.4 Shitja e kuotave si me siper perben objektin e kesaj Kontrate.

1.5 Ortaket e Shoqerise, kane rene dakord nepermjet Vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te dates 10.09.2010 per miratimin e transferimit te kuotave nepermjet kesaj Kontrate Shitblerje Kuotash.

1.6 Shoqeria ka marre deri ne Daten e Nenshkrimit te kesaj Kontrate vendimet e duhuara ne lidhje me kete transaksion dhe transferimin e kuotave nga Shitesi tek Bleresit.

1.7. Nepermjet kesaj blerjeje, dhe me firmosjen e kesaj Kontrate, Gentian Zguri do te zoteroje 30% te kuotave ne Shoqeri, ndersa Shitesi do te kete 55 % te kuotave te shoqerise nga 75% qe ai zoteronte fillimisht.

## NENI 2
## ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES

2.1. Çmimi total i blerjes se Kuotave ne Shitje eshte 100.00 (njëqind) leke secila, (**"Çmimi i Blerjes"**) dhe do te paguhet ne perputhje me kete nen, sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate.

2.2. Bleresi, do te paguaje Çmimin e Blerjes te barabarte me 20,000.00 (njezet mije leke) per te tere kuotat ne shitje, si me poshte vijon:

2.3 Me Daten e Nenshkrimit, Bleresi do te paguaje me vleren nominale te kuotave qe ai blen me transferte bankare ne llogarine rrjedhese te Shitesit. Cmimi i blerjes per secilen kuote do te jete 100.00 (njeqind) leke.

## NENI 3

## DEKLARIMET DHE GARANCITE E SHITESIT

### 3.1 DEKLARIME PARAPRAKE

3.1.1 Shitesi me ane te kesaj Kontrate deklaron dhe garanton ne lidhje me kuotat e zoteruara prej ti ne Shoqerine si dhe me Transaksionin qe parashikohet ne kete Kontrate, per te gjitha çeshtjet qe vijojne qe nga Nenshkrimi i saj.

3.1.2 Shitesi, gjithashtu, garanton se persa eshte ne dijeni aktualisht, çdo deklarim dhe garanci do te jete e vertete, e sakte dhe jo e keqperdorur ne Daten e Nenshkrimit.

### 3.1 ORGANIZIMI

3.1.1 Shoqeria eshte krijuar dhe themeluar rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk eshte ne gjendje paaftesie paguese apo ne falimentim, dhe ka fuqi te plote dhe kompetenca per te kryer aktivitetin e saj siç i kryen aktualisht si dhe te zoteroje asete dhe prona siç i zoteron aktualisht.

### 3.2 AUTORIZIMI

3.2.1 Te gjitha aktet ligjore dhe/ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar qe duhet te ndermerren nga ose per llogari te Shitesit dhe qe autorizojne Shitesin te lidhe dhe te zbatoje kete Kontrate jane kryer rregullisht.

### 3.3 PRONESIA

3.3.1 Shitesi eshte pronari dhe perfituesi i vetem dhe i ligjshem i gjithe kuotave qe perbejne Kapitalin e Shoqerise.

3.3.2 Kuotat ne Shitje jane te lira dhe te çliruara nga çdo Barre e çfaredo lloji dhe Shitesi ka te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per t'i shitur, per t'i kaluar, transferuar dhe dorezuar Kuotat ne Shitje ne perputhje me afatet e kesaj Kontrate.

3.3.3 Nuk ka asnje kontrate, marreveshje, ose detyrim qe krijon ose vendos ndonje Barre ne lidhje me Kuotat ne Shitje ose ndonje numer kuotash te autorizuara por te paemetuara ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka ndonje te drejte mbi ndonje Barre lidhur me ndonje nga Kuotat ne Shitje.

## NENI 4

## DEKLARIMET DHE GARANCITE E BLERESIT

4.1 Bleresi ne çastin e nenshkrimit dhe dorezimit te kesaj Kontrate, deklaron, se eshte ne dijeni te plote te gjendjes se Shoqerise nga momenti i themelimit e deri me daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate, si dhe i te gjitha detyrimeve qe ajo mund te kete ndaj paleve te treta, barret mbi asetet dhe/ose pronat, proceset gjygjesore dhe padite te ngritura prej dhe/ose kunder saj dhe se nenshkruan kete Kontrate me vetedije te plote duke hequr dore nga cdo pretendim i mevonshem ndaj Shitesit mbi cdo konflikti, shkelje apo mospermbushje, vendimi gjyqesor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje te detyrueshme dhe heq dore nga e drejta per te kerkuar perfundimin ose pavlefshmerine e kesaj Kontrate si dhe te kerkoje dembshperblim nga Shitesi per sa me siper permendur.

## NENI 5
## PREMTIME TE PERBASHKETA TE PALEVE

5.1. Palet do t'i sigurojne njera-tjetres çdo dhe te gjithe informacionin e nevojshem per perfundimin e kerij Transaksioni.

## NENI 6
## LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

6.1. Kjo Kontrate rregullohet nga ligji shqiptar. Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarrveshjeve qe lindin prej kesaj kontrate do e jete Gjykata e Rrethit Gjygjesor Tirane.

## NENI 7
## TE NDRYSHME

### 7.1. NDRYSHIMET

7.1.1. Çdo korrigjim, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem ne qofte se behet me shkrim dhe nenshkruhet nga ose per llogari te seciles Pale.

7.1.2. Mosushtrimi ose vonesa ne ushtrimin e nje te drejte ose mase mbrojtese, qe parashikohen ne kete Kontrate ose nga ligji, nuk perben heqje dore nga e drejta ose masa mbrojtese, ose heqje dore nga te drejta ose masa te tjera mbrojtese. Mosushtrimi i vetem ose i pjesshem, i nje te drejte ose mase mbrojtese, qe parashikohen ne kete Kontrate ose nga ligji, nuk pengon ushtrimin e metejshem te se drejtes ose mases mbrojrese ose ushtrimin e nje te drejte ose mase tjeter mbrojtese.

## 7.2. KALIMI I TE DREJTAVE

7.2.1 Kjo Kontrate eshte detyrimi ligjot dhe ne perfitim te Paleve, trashegimtareve te tyre dhe personave te cileve u kalojne keto te drejta.

## 7.3. KOSTOT DHE TAKSAT

7.3.1 Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, secila Pale do te paguaje shpenzimet e saj ne lidhje me negocimin, hartimin, nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate dhe te shtojcave te saj. Çdo dhe te gjitha shpenzimet noteriale per nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate do te paguhen nga Bleresi.

## 7. 4. TERESIA E KONTRATES

7.4.1 Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote dhe zevendeson çdo marreveshje te meparshme midis Paleve qe lidhet me objektin e kesaj Kontrate.

* * * * *

Une, Noteri, pasi ua lexova Paleve me ze te larte kete Kontrate, te hartuar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen Shqipe u binda se Palet e gjejne ate ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe Une vertetoj nenshkrimin e tyre sipas Ligjit Shqiptar.

TIRANE, me 10.09.2010

| | |
|---|---|
| HYSNI YMERI | GENTIAN ZGURI |
| Per Shitesin | Per Bleresin |
| Hysni YMERI | Gentian ZGURI |

NOTERI